



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 02 Prot.

Tiranë, më 05 / 01 /2021

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 1 datë, 05 . 01.2021

PËR

**DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT/TRANSFERTË E
PAKUSHTËZUAR, PËR VITIN 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, vendimin Nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për detajimin fondeve të akorduara për Universitetin Politeknik të Tiranës, në formë grant/transfertë e pakushtëzuar, për vitin 2021, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Kryetar
Arben DHIMA

Anëtar
Ardian NAÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/ Prot.
2

Tiranë, më 13 / 01 /2021

V E N D I M

Nr. 2 datë, 13 . 01 . 2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE PËRFITIMIN E BURSËS, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJEN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2020 - 2021

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodi Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, VKM – në nr. 39 dhe nr. 40, datë 23.01.2019, VKM – në nr. 780, datë 26.12.2018, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 70, datë 13.01.2021, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit dhe përfitimin e bursës financiare, për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Pagesa e bursave financiare për studentët përfitues, të kryhet nga fillimi i vitit akademik 2020 – 2021.

4. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/3 Prot.

Tiranë, më 13 / 01 /2021

V E N D I M

Nr. 3 datë, 13 . 01 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM/REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021, SI KATEGORI ME KRITERE TË VEÇANTA

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodi Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, VKM – në nr. 39 dhe nr. 40, datë 23.01.2019, VKM – në nr. 780, datë 26.12.2018, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 70/1, datë 13.01.2021, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë dhe në një program të ciklit të dytë, që përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare për vitin akademik 2020 - 2021, si kategori me kriterë të veçanta, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultete përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/ Prot.
6

Tiranë, më 02/02/2021

V E N D I M

Nr. 5 datë 02 . 02 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN NË PARIM TË PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 4, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 21 dhe nr. 22, datë 22.12.2020 të Senatit Akademik, Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Inxhinierisë Informatike, në Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit, Profili Inxhinieri Informatike,
2. Të miratojë në parim propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit, në Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit, Profili Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/5 Prot.

Tiranë, më 02 / 02 /2021

V E N D I M

Nr. 4 datë 02 . 02 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
DOKTORATËS NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 4, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 23, datë 22.12.2020 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Departamenti i Burimeve të Energjisë, në Inxhinieri Naftë dhe Gazi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/7 Prot.

Tiranë, më 02/02 /2021

V E N D I M

Nr. 06 datë 02.02. 2021

P Ë R

**MIRATIMIN E MASËS SË PAGESËS SË PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË
KOMISIONIN PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK, KOMISIONET E
PËRHERSHËM TË DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”, KËSHILLIN
E ETIKËS, SI DHE KOMISIONET ZGJEDHORE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK
TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 105, Vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 18, Statutin e UPT - së nenin 10, pika o, rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, pika 7, neni 7, pika 10, si dhe neni 39, pika 6, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 17, datë 03.12.2020 të Senatit Akademik “Mendim i argumentuar mbi masën e shpërblimit të disa organeve kolegjiale në Universitetin Politeknik të Tiranës” si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 151/3 prot, datë 12.10.2020, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e pagesës së personelit të angazhuar në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik, Komisionet e Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore “doktor”, Këshillin e Etikës, si dhe komisionet zgjedhore (Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete dhe Komisioni i Apelimit), në Universitetin Politeknik të Tiranës, si më poshtë:

Komisioni i Promovimi të Personelit Akademik (KPPA)

- Kryetari - 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë/mbledhje, deri në 9 mbledhje në vit.
- Anëtarët - 23.000 (njëzet e tre mijë) lekë/mbledhje, deri në 9 mbledhje në vit.
- Sekretari – 10.000 (dhjetë mijë) lekë/mbledhje, deri në 9 mbledhje në vit.

Komisioni i Përhershëm i Dhënies së Gradës Shkencore (Doktor) (KP)

- Anëtarët – 10.000 (dhjetë mijë) lekë/mbledhje deri në 9 mbledhje në vit.
- Sekretari – 7000 (shtatë mijë) lekë/mbledhje deri në 9 mbledhje në vit.

Këshilli i Etikës (KE)

- Anëtarët – 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/mbledhje deri në 9 mbledhje në vit.
- Sekretari – 10.000 (dhjetë mijë) lekë/mbledhje deri në 9 mbledhje në vit.

Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ)

- Kryetari 5.000 (pesë mijë) lekë/mbledhje;
- Anëtarët 4.000 (katërmijë) lekë/mbledhje;
- Sekretari 3.000 (tre mijë) lekë/mbledhje;

Komisionet Zgjedhore në Fakultete/Institut (KZF)

- Kryetari 4.000 (katër mijë) lekë/mbledhje;
- Anëtarët 3.000 (tre mijë) lekë/mbledhje;
- Sekretari 2.000 (dy mijë) lekë/mbledhje;

Komisioni Apelimit (KA)

- Kryetari 10.000 (dhjetë mijë) lekë/mbledhje;
 - Anëtarët 9.000 (nëntë mijë) lekë/mbledhje.
2. Përfshihen nga e drejta e përfitimit të masës së shpërblimit, personeli i angazhuar në më shumë se 2 organe kolegjiale të Universitetit Politeknik të Tiranës.
 3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2021.
 4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/8 Prot.

Tiranë, më 02/02 /2021

V E N D I M

Nr. 8 datë, 02 . 02 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM/REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021, SI KATEGORI ME KRITERE TË VEÇANTA

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, VKM – në nr. 39 dhe nr. 40, datë 23.01.2019, VKM – në nr. 780, datë 26.12.2018, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 70/4, datë 01.02.2021, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë dhe në një program të ciklit të dytë, që përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare për vitin akademik 2020 - 2021, si kategori me kritere të veçanta, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/10 Prot.

Tiranë, më 02 / 02 /2021

V E N D I M

Nr. 9 datë 02 . 02 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR PERIUDHËN 2021 - 2023**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja 1, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe shkresën nr. 1270 prot, datë 29.10.2020 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, për periudhën 2021 - 2023, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Arben DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 70/11 Prot.

Tiranë, më 02 / 02 /2021

V E N D I M

Nr. 10 datë 02 .02. 2021

P Ë R

**MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PERSONELIT TË CAKTUAR PËR
KRYERJEN E DETYRAVE JASHTË FUNKSIONIT ORGANIK PRANË IGJEUM**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 18, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe shkresën e IGJEUM nr. 334 prot, datë 12.10.2020, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e shpërblimit për Znj. Anira Gjoni, me detyrë specialiste në Departamentin e Klimës dhe Mjedisit, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, për kryerjen edhe të detyrave së zëdhënësit të IGJEUM.
2. Masa e shpërblimit për kryerjen e detyrave jashtë funksionit organik, të jetë 2 (dy) paga mujore në vit.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Instituti i Gjeoshkencave, Ujit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 704/1 Prot.

Tiranë, më 27/04/2021

V E N D I M

Nr. 11 datë 27.04.2021

P Ë R

**MIRATIMIN KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT PËR PROGRAMIN E CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MEKANIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 6, datë 29.09.2020 të Senatit Akademik, Vendimin nr. 28, datë 20.11.2020 të Bordit të Administrimit, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 704 prot., datë 27.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për programin e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Mekanikës, në fushën e “Elementeve të Konstruksioneve Mekanike dhe Integritetit Struktural” për projektin:

“Metodat e avancuara për llogaritjet e elementeve të makinave, strukturave mekanike dhe vlerësimin e integritetit të tyre”.

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlogaritet në shumën 2.076.000 (dy milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqindë mijë) lekë.

2. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit, do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit vetëm për personelin akademik të brendshëm të UPT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 704/ Prot.
2

Tiranë, më 27 / 04 /2021

V E N D I M

Nr. 12 datë 27 . 04 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT PËR PROGRAMIN E CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË “INXHINIERI ELEKTRIKE”
DREJTIMI ELEKTROENERGJITIKË, SI DHE DREJTIMI AUTOMATIZIM I
INDUSTRIË, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 7 dhe nr. 8, datë 29.09.2020 të Senatit Akademik, Vendimin nr. 28, datë 20.11.2020 të Bordit të Administrimit, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 704 prot., datë 27.04.2011, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për programin e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në “Inxhinieri Elektrike”, drejtimi Automatizim i Industrisë, pranë Departamentit të Automatikës, për projektin:

“Zbatimi i teknologjisë industri 4.0 për automatizimin e proceseve industriale”.

Kosto e studimit për këtë projekt, përlogaritet në shumën 4.397.340 (katër milion e treqindë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqindë mijë) lekë.

2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për programin e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në “Inxhinieri Elektrike”, drejtimi Elektroenergjitikë, pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike për projektin:

“Ndërveprimi i teknologjive informatike dhe energjitike për një sistem elektroenergjitik të mençur “smart grid”.

Kosto totale e studimit për këtë projekt, përlogaritet në shumën 3.948.000 (tre milion e nëntëqind e dyzetë e tetë mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 374.400 (treqindë e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit, do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit vetëm për personelin akademik të brendshëm të UPT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Arben DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 704/ Prot.
3

Tiranë, më 27/04 /2021

V E N D I M

Nr. 13 datë 27.04 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT PËR PROGRAMIN E CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË
DHE TË MINIERAVE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 23, datë 22.12.2020 të Senatit Akademik, vendimin nr. 4, datë 02.02.2021 të Bordit të Administrimit, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 704 prot., datë 27.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për programin e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi”, pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë, për projektin:

“Polimerët në industrinë e naftës, efektiviteti teknik dhe ndikimi në koeficientin e naftënxjerrjes, vlerësime ekonomiko-financiare”

Kosto totale e studimit përlogaritet në shumën 2.413.216 (dy milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 302.500 (treqind e dy mijë e pesëqind) lekë.


2. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit, do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit vetëm për personelin akademik të brendshëm të UPT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 704/16 Prot.

Tiranë, më 27/04 /2021

V E N D I M

Nr. 16 datë 27.04.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
SË NDËRTIMIT, SI DHE MIRATIMIN E KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 29, datë 14.04.2021 të Senatit Akademik, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 704, datë 27.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në “Inxhinieri Ndërtimi”, profili Inxhinieri Mjedisi, pranë Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit.
2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për riorganizimin e programit të sipërcituar, për projektet:

a. *“Vlerësimi sasior dhe monitorimi i gazeve serrë në qytete”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 4.990.000 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

b. *“Performanca mjedisore si një tregues i matshëm në tregun e vlerësimit të pasurive (ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale)”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 2.100.000 (dy milion e njëqind mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

c. *“Vlerësimi i erozionit dhe i riskut nga pëmbytjet detare në zonën e ulët bregdetare të Shqipërisë”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 2.150.000 (dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

d. *“Rajonizimi i territorit të Shqipërisë sipas karakteristikave hidrologjike”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

e. *Politikat e ndryshme klimatike nën optikën e kërkimit shkencor. Studimi i masave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe masave për minimizimin e efekteve të ndryshme klimatike në mjedis dhe në sektorë të ndryshëm të ekonomisë”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 2.100.000 (dy milion e njëqind mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

f. *Analizë komplekse e sigurisë së digave të sistemit të bujqësisë – zona e Gjirit të Lalëzit, Njësia Ishëm”.*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlllogaritet në shumën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit, do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit vetëm për personelin akademik të brendshëm të UPT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 704/17 Prot.

Tiranë, më 27/04 /2021

V E N D I M

Nr. 17 datë 27.04 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
SË NDËRTIMIT, SI DHE MIRATIMIN E KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 28, datë 09.04.2021 të Senatit Akademik, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 704 prot., datë 27.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në “Gjeodezi”, pranë Departamentit të Gjeodezisë.
2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për riorganizimin e programit të sipërcituar, për projektet:

- a. *“Realizimi i sistemit të referencës gjeodezike vertikale (RGC) të RSH”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlogaritet në shumën 2.818.000 (dy milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

- b. *“Transformimi i referencave gjeodezike të ndryshme të RSH me metodën e KOLOKACIONIT”;*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlogaritet në shumën 2.400.000 (dy milion e katërqind mijë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

- c. *Krahasimi i metodave të ndryshme të Fotogrametisë Digjitale (UAV; skanime me LIDAR; Laser, Skaner) në rilevimet e objekteve komplekse inxhinierike”.*

Kosto totale e studimit për këtë projekt përlogaritet në shumën 3.387.520 (tre milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë) lekë;

Tarifa e studimit për 3 vite në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit, do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit vetëm për personelin akademik të brendshëm të UPT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 649/3 Prot.

Tiranë, më 27/04 /2021

V E N D I M

Nr. 19 datë 27.04 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT TË
ADMINISTRATORIT NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja f dhe neni 53, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe propozimin e Administratorit të Institucionit nr. 649/2 prot., datë 19.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret dhe procedurën e punësimit të Administratorit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO


Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Arben DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 649/14 Prot.

Tiranë, më 27/04 /2021

V E N D I M

Nr. 20 datë 27.04 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT PËR
PËRGJEGJËSIN E SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja f, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret dhe procedurën e punësimit për pozicionin e Përgjegjës në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Arben DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 649/5 Prot.

Tiranë, më 24/04 /2021

V E N D I M

Nr. 21 datë 24.04.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME NOTË MESATARE TË PAKTËN 6
(GJASHTË), TË CILËT PËRFITOJNË REDUKTIM TË TARIFËS SË
SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 649/1 prot., datë 19.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve me notë mesatare të paktën 6 (gjashtë), të cilët përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim t’i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2021.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Alba THOMA

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Irida VEJSIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Arben DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 649/6 Prot.

Tiranë, më 24/04 /2021

V E N D I M

Nr. 22 datë 24.04 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM/REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 649 prot., datë 19.04.2021, në mbledhjen e datës 27.04.2021 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë dhe në një program të ciklit të dytë, që përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2021.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 307/2 Prot.

Tiranë, më 12 / 05 /2021

V E N D I M

Nr. 23 datë 12.05.2021

P Ë R

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
“MASTER I SHKENCAVE” NË INXHINIERI MEKATRONIKE NË FAKULTETIN
E INXHINIERISË ELEKTRIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 31, datë 07.05.2021 të Senatit Akademik, si dhe mbështetur në relacionin e Administratorit të Institucionit;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Inxhinieri Mekatronike në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 748/12 Prot.

Tiranë, më 12/05 /2021

V E N D I M

Nr. 24 datë 12.05.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË BACHELOR, SI DHE PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER I
SHKENCAVE” DHE “MASTER PROFESIONAL” NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK
TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 69, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës neni 52, pika 4 dhe neni 9, pika 3, vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën e Rektoratit Nr.422/2 datë 7.05.2021, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit të datës 11.05.2021, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë Bachelor, si dhe programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2021 – 2021, sipas dokumentit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 25/
B Prot.

Tiranë, më 14 / 06 / 2021

V E N D I M

Nr. 26 datë 14 . 06 . 2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM/REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 25/5 prot., datë 08.06.2021, në mbledhjen e datës 17.06.2021 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë dhe në një program të ciklit të dytë, që përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2021.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 25/19 Prot.

Tiranë, më 17/06 /2021

V E N D I M

Nr. 27 datë 17.06.2021

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME NOTË MESATARE TË PAKTËN 6 (GJASHTË), TË CILËT PËRFITOJNË REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 25/7 prot., datë 17.16.2021, në mbledhjen e datës 17.06.2021 Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve me notë mesatare të paktën 6 (gjashtë), të cilët përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2020 - 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2021.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 25/10 Prot.

Tiranë, më 14/06 /2021

V E N D I M

Nr. 28 datë 14.06.2021

P Ë R

MIRATIMIN E KANDIDATIT TË PËRZGJEDHUR FITUES PËR ADMINISTRATOR
NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1/f, neni 52, pika 1/e, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 19, datë 27.04.2021 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e kriterëve dhe procedurës së punësimit të administratorit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike”, vendimin nr. 123, datë 21.05.2021 “Për përzgjedhjen e kandidatit fitues të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike”, si dhe relacionin nr. 711/3 prot., datë 24.05.2021 të Administratorit të Institucionit, në mbledhjen e datës 17.06.2021, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

3. Të miratojë kandidatin e përzgjedhur fitues për administrator në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Znj. Ingrida Sinaj.
4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 632/ Prot.
12

Tiranë, më 06/07/2021

V E N D I M

Nr. 29 datë 06.07.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNËS TË KRYERA JASHTË KOHËS
NORMALE TË PUNËS DHE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR, NGA PUNONJËSIT E
SEKRETARIVE MËSIMORE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja ë, udhëzimin nr. 10 datë 15.05.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar me udhëzimin nr. 17, datë 30.07.2019 dhe nr. 15, datë 26.05.2020, Urdhrin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 2, datë 02.07.2020 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021”, të ndryshuar me urdhrin nr. 3, datë 06.08.2020 dhe nr. 4, datë 30.09.2020, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Urdhrin nr. 72, datë 02.09.2020 të Rektorit të UPT – së “Për ndryshimin e orarit të punës të Sekretarive Mësimore gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 25/3 prot, datë 08.06.2021, Bordi i Administrimit i UPT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të punës dhe në ditët e pushimit javor nga punonjësit e sekretarive mësimore, në periudhën 1 shtator – 31 tetor 2020, për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve fitues në vitin akademik 2020 – 2021, jo më shumë se 137 orë.

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 649/ Prot.
7

Tiranë, më 06 / 07 /2021

V E N D I M

Nr. 31 datë 06 .07 .2021

P Ë R

**NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT ADHOC NË PROCEDURËN E
PUNËSIMIT PËR PËRGJEGJËSIN E SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 20, datë 27.04.2021 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurës së punësimit për përgjegjësin e sektorit të auditit të brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës”, në mbledhjen e datës 06.07.2021, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e përbërjes së komisionit *ad hoc*, në procedurën e punësimit për Përgjegjësin e Sektorit të Auditit të Brendshëm, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Komisioni *ad hoc* të përbëhet nga 3 anëtarë si më poshtë:
 - Drejtori i Drejtorisë Ekonomike;
 - Personi përgjegjës për burimet njerëzore;
 - Personel akademik i propozuar nga Rektori.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1318 Prot.

Tiranë, më 05 / 08 /2021

VENDIM

Nr. 32 datë 05 . 08 . 2021

“PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2020 – 2022 NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”

Mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës” dhe shkresës së MASR Nr. 4193/3, datë 03.08.2021,

VENDOSI:

Të miratojë në parim Fondet Grant dhe Fondet nga të Ardhurat Dytesore bazuar në draft Buxhetin 2021, të paraqitura në Bordin e Administrimit prej Senatit të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas relacionit shpjegues si dhe pasqyrave shoqëruese bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARBEN DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1768 Prot.

Tiranë, më 04 / 11 /2021

V E N D I M

Nr. 33, datë 04 . 11 .2021

P Ë R

KONSTITUIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 48 e vijues, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, urdhrin nr. 412, datë, 22.10.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për emërimin në detyrë të anëtarëve së Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin", vendimin nr. 40, datë 24.09.2021 të Senatit Akademik "Për miratimin e anëtarëve përfaqësues të Universitetit Politeknik të Tiranës në Bordin e Administrimit", vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e parë të tij, të zhvilluar sot më datë 03.10.2021 në prani të të gjithë anëtarëve,

V E N D O S I:

1. Konstituimin e Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës, me përbërje si më poshtë:

- | | |
|-------------------|--|
| • Adriana RISTANI | (Përfaqësues i MAS) |
| • Mirela BIMO | (Përfaqësues i MAS) |
| • Jorgaq KAÇANI | (Përfaqësues i MAS) |
| • Fatjon DHULLI | (Anëtar i përkohshëm sipas përcaktimit në urdhrin e MAS) |
| • Arjan BEQIRAJ | (Përfaqësues i UPT) |
| • Ardian NAÇO | (Përfaqësues i UPT) |
| • Alfred PJETRI | (Përfaqësues i UPT) |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1768/1 Prot.

Tiranë, më 04 / 11 /2021

V E N D I M

Nr. 34, datë 04 . 11 .2021

P Ë R

ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 48 e vijues, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e parë të tij, të zhvilluar në datën 03.10.2021, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij,

V E N D O S I:

1. Të zgjedhë në detyrën e kryetarit të Bordit të Administrimit, Znj. Adriana RISTANI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMCO

Anëtar
Fatjon DHULI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1845 Prot.

Tiranë, më 11 / 11 /2021

V E N D I M

Nr. 35, datë 11 . 11 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2021”

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, Statutin e UPT - së, neni 10, pika 2, shkronja b, vendimin Nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin e Senatit Akademik Nr.18, datë 03.12.2020 “Per miratimin e Projektbuxhetit Afatmesëm 2021-2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr.1075 prot., datë 16.06.2021 të Senatit Akademik “Dërgohet Vendimi i Senatit Akademik”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11.11.2021, me shumicë të anëtarëve të tij,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2020;
2. Të miratojë buxhetin e vitit 2021, sipas tabelave dhe relacionit shoqërues të tij, bashkëlidhur këtij vendimi;
3. T’i propozojë Rektoratit fillimin e procedurës për rishikimin e strukturës së përgjithshme të institucionit, në përputhje me numrin e punonjësve të parashikuar në PBA 2021 – 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1889/13 Prot.

Tiranë, më 10/12 /2021

V E N D I M

Nr. 34, datë 10.12.2021

P Ë R

MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER
PROFESIONAL NË ELEKTROENERGJITIKË” ME 120 KREDITE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 43, datë 25.11.2021 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 1889/1 prot., datë 26.11.2021 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Elektroenergjitikë” me 120 kredite, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.
2. Tarifa totale e shkollimit në këtë program studimi është 96.800 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë për student.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1966/3 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 /2021

V E N D I M

Nr. 38, datë 10 . 12 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI E BURIMEVE MINERARE, PROFILI INXHINIERI MINERARE DHE MARKSHAJDERI” ME 120 KREDITE, NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 42, datë 25.11.2021 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 1966/1 prot., datë 26.11.2021 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi” me 120 kredite, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave.
2. Tarifa totale e shkollimit në këtë program studimi është 156.000 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë për student.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1421/13 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 /2021

V E N D I M

Nr. 39, datë 10 . 12 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIT TË
BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
PERIUDHËN 2022 - 2024

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja I, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 1421/1prot, datë 15.11.2021 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, për periudhën 2022 - 2024, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1012/3 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 /2021

V E N D I M

Nr. 40, datë 10 . 12 .2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË STUDENTIT SAIMIR GJOCAJ PËR REDUKTIMIN
NGA TARIFA VJETORE E STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1017/2 prot., datë 01.12.2021, Bordi i Administrimit i UPT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e studentit Saimir Gjocaj, student në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, për reduktimin nga tarifa vjetore e studimit në vitin akademik 2020 - 2021.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1017/4 Prot.

Tiranë, më 10/12 /2021

V E N D I M

Nr. 41, datë 10.12.2021

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË STUDENTES THEODHORA DHAME PËR
REDUKTIMIN NGA TARIFA VJETORE E STUDIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1017/2 prot., datë 01.12.2021, Bordi i Administrimit i UPT-së me shumicë të votave të anëtarëve të tij,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e studentes Theodhora Dhame, studente në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për reduktimin nga tarifa vjetore e studimit në vitin akademik 2020 - 2021.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1845/5 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 /2021

V E N D I M

Nr. 42, datë 10 . 12 .2021

P Ë R

MIRATIMIN E VLERËS MESATARE TË TREGUT TË PËRLLLOGARITUR PËR
SHËRBIMIN E KËRKUAR NGA MINISTRIA E KULTURËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 188, datë 13.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, pika 2 dhe 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 1845/4 prot, datë 17.11.2021 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifën në vlerën 2,920,800 (dy milion e nëntëqind e njëzet mijë e tetëqind) lekë me TVSH, si vlerë mesatare e tregut, përlllogaritur për shërbimin e kërkuar nga Ministria e Kulturës, me objekt “Hartimi i planit të integruar të menaxhimit të Pallatit të Brigadave dhe parkut të tij”, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

